

## **NË EMER TË POPULLIT**

GJYKTA E APELIT E KOSOVËS- Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët, Driton Muharremi, kryetar i kolegjit, Fillim Skoro, gjyqtar referues dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Eroll Gashi, si procesmbajtës, në çështjen penale të akuzuarit Sh.J. nga Istogu, për shkak të veprave penale, marrja e rryshfetit, nga neni 428 par.2 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore DKR në Pejë, ankesës së mbrojtësit të akuzuarit Sh.J., av.K.S., të cilin me autorizim zëvendësues e ka përfaqësuar av.D.Z., të paraqitur kundër aktgjykimi të Gjykatës Themelore DKR në Pejë, PAKR.nr.1/2017, të dt.16.06.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 par.1 të KPPK- së, me datë 09.11.2017, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

Refuzohen të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore DKR në Pejë dhe ankesës e mbrojtësit të akuzuarit Sh.J. dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore DRK në Pejë, PAKR.nr.1/2017, i dt.16.06.2017, vërtetohet.

### **A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore DRK në Pejë, PAKR.nr.1/2017, i dt.16.06.2017, i akuzuari Sh.J., është shpall fajtor për veprën penale marrje e rryshfetit nga neni 428 par.2 të KPRK-së, dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti, në të cilin dënim të akuzuarit i është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak, nga data 03.06.2014 e deri me datën 03.09.2014, të cilin dënim do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 300(treqind), të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 60(gjashtëdhjetë)dite, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, po që se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, atëherë dënimi me gjobë do të revokohet dhe do të shndërrohet në dënim me burg efektiv e ku një ditë burg do ti llogaritet në shumë prej 20Euro si dhe dënimin plotësues ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik në kohëzgjatje prej 1(një)viti, i cili dënim plotësues do të filloj së aplikuari pas vuajtjes së dënimit kryesorë nga ana e të akuzuarit.

Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, gjykatës t'ia paguaj shumën prej 50Euro, si dhe në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësorë, gjykatës t'ia paguajë shumën prej 50Euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

I akuzuari konfrom nenit 364 par.1 nën par 1.3 të KPPK-së, është liruar nga aktakuza për pikën 2 , për veprën penale marrja e ryshfetit, nga neni 428 par.2 të KPRK-së, ngase nuk është provuar se i akuzuari ka kryer këtë veprë për të cilën është akuzuar. Shpenzimet e procedurës penale për këtë veprë penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor, ankesë kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore DKR në Pejë, për shkak të vërtetimit të gabuar jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e ankimuar të ndryshoj, ashtu që të akuzuarin në fjalë ta shpallë fajtor për të gjitha pikat e aktakuzës dhe ti shqiptoj një dënim më të ashpër, konformë ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.J., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata e Apelit, ta anuloj aktgjykimin e ankimuar dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe vendim ose ta ndryshoj në atë mënyrë që të akuzuarin Sh.J., ta liroj nga akuza për veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.2 të KPRK, sepse nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të akuzuarit Sh.J., av.K.S., duke propozuar që Gjykata e Apelit, ankesën e Prokurorisë në Pejë ta refuzoi si të pabazuar.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPAI.nr.337/17, të dt.20.07.2017, ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Themelore DKR në Pejë, ndërsa ankesa dhe përgjigja në ankesë e mbrojtësit të akuzuarit, të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata konform nenit 390 par.4 të KPPK, mbajti seancën e kolegjit, në të cilën prezantoi i akuzuari Sh.J. dhe mbrojtësi i tij, av.D.Z., me autorizim zëvendësues, ndërsa në seancë nuk morën pjesë Prokurori i Apelit, i dëmtuari R.Th., si dhe mbrojtësi i të akuzuarit av.K.S., edhe pse janë njoftuar me rregull për vendin dhe kohën e mbajtjes.

Gjykata shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e Prokurorisë dhe ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit, përgjigjen në ankesë të mbrojtësit të akuzuarit, analizoj edhe shkresat tjera në lëndë dhe gjeti se:

Ankesa e PTH-DKR në Pejë dhe ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit, janë të pabazuara. Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës.

Prokuroria Themelore, në ankesën e saj pretendon se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për arsye se nga data bazat e NJHT në Pejë, është gjetur narkotik te i burgosuri i burgut të Dubravës, R.M., pastaj se i njëjti ka dëshmuar se i akuzuari ka sjellë edhe dhjetë

telefona, të njëjtat sipas ankesës se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, është deklarata e dëshmitarit R.Th., nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, edhe pse i njëjti ka deklaruar se i akuzuari Sh.J., prej vitit 2002, e tutje ka sjellë dhe ka futur në burgun e Dubravës, narkotik dhe telefona dhe shumica prej të burgosurve kanë paguar si kundër shpërblim në emër të rryshfetit të akuzuarit Shaqir.

Ankesa pretendon se edhe vendimi mbi dënimin është i butë, i cili dënim prej 1 (një) viti, nuk është në përpjesëtim me peshën e veprës penale, duke marrë parasysh se për këtë veprë penale është paraparë dënim me gjobë dhe dënim me burgim prej 3 deri në 12 vite.

Mbrojtësi i të akuzuarit Sh.J., në ankesën e tij pretendon se aktgjykimi është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për shkak se gjykata nuk ka dhënë arsytet e qarta dhe të plota në çdo pikë të akuzës, dhe nuk ka dhënë vlerësime të qarta lidhur me faktet vendimtare, për të cilën veprën penale të marrjes së rryshfetit për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor. Edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, për arsye se dëshmia e dëshmitarit R.Th., nuk është kredibile dhe në çështjen në faktet vendimtare është në kundërshtim me vetveten, për arsye se ai disa herë ndryshon deklaratat gjatë dhënies së tyre si në procedurën hetimore ashtu në shqyrtimin gjyqësor. Edhe video incizimi nuk vërteton në mënyrë të saktë kryerjen e veprës penale, për arsye se nuk janë dëgjuar zërat të cilët me rastin e simulimit të veprës penale.

Si pasojë e këtyre shkeljeve është shkelur Ligji Penal, në dëm të akuzuarit, për arsye se i akuzuari Sh.J., ditën kritike është vënë në lajthim duke qenë i bindur se është duke pranuar borxhin të cilin ia kishte dëshmitari R.Th.. Si pasojë e shkeljeve të cekura më lartë, edhe vendimit mbi dënimin është i pabazuar për arsye se gjykata në këtë çështje penale është dashur që të merr aktgjykim lirues për veprën penale, marrja e rryshfetit nga neni 428 par.2 të KPRK.

Gjykata e Apelit duke e shqyrtuar aktgjykimin e ankimuar sipas pretendimeve ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 par.1 të KPPK gjen se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.12 lidhur me nenin 370 par.7 të KPPK, lidhur me pjesën dënuese për veprën penale marrja e rryshfetit nga neni 428 par.2 të KPRK, të përshkruar si në dispozitivin nën I dhe për pjesën liruese të veprës penale marrja e rryshfetit nga neni 428 par.2 të KPRK, të përshkruar si në dispozitivin II të aktgjykimimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, për pjesën dënuese dhe liruese, gjykata ka dhënë arsye të qarta dhe të plotë lidhur me faktet vendimtare rreth argumentimit të kryerjes së veprës penale të marrjes së rryshfetit nga neni 428 par.2 të KPRK, të përshkruar si në dispozitivin nën I, nga provat dhe dëshmitë e dëshmitarëve janë të bindshme se i akuzuari Sh.J., ka pranuar telefonin celular të tipit HTC "SIN-HTOAXPY03294, dhe shumën prej 300Euro, që t'ia dorëzoi të burgosurit R.Th., i cili ka qenë në vuajtje të dënimit në Qendrën Korrektuese në Dubravë, e në bazë të simulimit të veprës penale, nga ana DKKO, të cilën e kanë kryer hetuesit, dëshmitarët Sh.B. dhe B.S., i cili simulim është kryer në bashkëpunim me dëshmitarin R.Th.. Nga kjo provë, si provë materiale, si dhe dëgjimi i dëshmitarëve dhe provave tjera, gjykata e shkallës së parë, ka nxjerrë përfundim të drejtë se në veprimet e të akuzuarit, janë formuar të gjitha elementet e veprës penale të marrjes së rryshfetit, dhe ka nxjerrë konkludim të drejtë, se i akuzuari Sh.J. ka kryer veprën penale dhe i njëjti është juridiko penalisht përgjegjës. Aktgjykimi i ankimuar edhe për pjesën liruese është i qartë dhe i kuptueshëm për arsye se periudha kohore prej vitit 2002, për të cilën ekziston dyshimi se i akuzuari Shaqir, është marrë me futjen e gjësendeve të pa lejueshme në Qendrën Korrektuese në Dubravë, nuk janë vërtetuar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga provat e nxjerra në shqyrtim gjyqësor, për arsye se dëshmia e dëshmitarit R.Th. dhe dëshmitarëve tjerë, për këtë pjesë janë kontradiktore dhe nuk jep siguri të besueshme qartë

lidhur me faktet vendimtare, edhe pse PTH-DKR në Pejë, sipas kësaj baze ankimore nuk ka paraqitur ankesë ,e Gjykata e Apelit këtë bazë ankimore e ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare.

Nga të më lartë, rezulton që aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë në shkeljet e pretenduara ankimore të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nën par.1.12 e në lidhur me nenin 370 të KPP.

Pretendimet ankimore të paraqitura në dy ankesat se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit janë të pabazuara, për arsye se nga dëshmitë e dëshmitarëve R.Th., provave të nxjerra në shqyrtimi gjyqësor dhe blerjes së simuluar në mënyrë të pa dyshimtë është vërtetuar se i akuzuari Sh.J., në cilësinë e personit zyrtar e në kundërshtim me ligjit ka pranuar shumë prej 300Euro, gjë që vërtetohet edhe nga dëshmitë dhe provat e nxjerra në shqyrtimin gjyqësor, e sidomos nga blerja e simuluar.

Pretendimet ankimore për pjesën liruese, se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, janë të pabazuara për arsye se vetë deklarata e dëshmitarit R.Th., i cili ka qenë në vuajtje të dënimit në Qendrën Korrektuese në Dubravë, nga vitit 2001 e këndej, ku ka qenë i punësuar edhe i akuzuari Sh.J., nuk mund me siguri të vërtetohen edhe futjet e gjësendeve tjera të pa lejueshme në Qendrën Korrektuese në Dubravë, si narkotik, telefona dhe gjësende tjera të pa lejueshme, për arsye se deklarata e dëshmitarit dhe provat tjera nuk japin një pasqyrë reale dhe këto prova gjithmonë varësisht prej situatës e sidomos deklaratat e dëshmitarit R.Th., nuk kanë ndonjë kredibilitet të besueshëm për faktin se ato janë ndryshuar disa herë, e duke marrë parasysh pozitën e tij se ai ka qenë si i burgosur në vuajtjen e dënimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, edhe për pjesën liruese gjykata ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, duke dhënë argumente të qarta dhe të plotë, e kjo për faktin se për ekzistimin e fakteve të rëndësishme, e siç është rasti me futje e gjësendeve të ndryshme, e të cilat janë të kontestueshme, ato gjithmonë interpretohen në favor të akuzuarit.

Pretendimet ankimore se është shkelur ligji penal nga neni 385 par.1 të KPP, e në të cilën gjykata shikon sipas detyrës zyrtare nuk qëndrojnë dhe gjykata e shkallës së parë, drejtë ka aplikuar ligjin penal, kjo për arsye se i akuzuari Sh.J., është person zyrtar, se ka vepruar në kundërshtim me detyrën e tij, me marrjen e 300 Eurove, nga vepra penale e simuluar e me të cilin ka bashkëpunuar dëshmitarin R.Th., me dëshmitarët Sh.B. dhe B.S., si hetues të DKKO, të cilën e kanë kryer edhe masën blerja e simuluar, ndërsa edhe për pjesën liruese nuk është shkelur ligji penal dhe gjykata e shkallës së parë, drejtë ka vepruar kur të akuzuarin e ka liruar nga akuza për veprën penale si nën dispozitivin II të aktgjykimit, për arsye të ekzistimit të mëdysheve rreth kryerjes së veprës penale, e të cilat gjithmonë interpretohen në favor të akuzuarit.

Sa i përket bazës ankimore të vendimit mbi dënimin Gjykata e Apelit, rrethanat rënduese dhe lehtësuese të cilat janë marrë nga gjykata e shkallës së parë, i merr si të vërtetuara, kjo për arsye se gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimit ka marrë parasysh rregullat e përgjithshme mbi matjen e dënimit, të cilat janë paraparë si në nenin 73 të KPRK-së dhe gjykata në mënyrë të drejtë ka vlerësuar peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë dhe sjelljet e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale dhe dënimi i shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti, e në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej dt.30.06.2014, gjerë me dt.03.09.2014, është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, për arsye se në asnjërën ankesë nuk janë paraqitur ndonjë rrethanë posaçërisht rënduese, respektivisht lehtësuese që kishte me ndikuar në ashpërsimin, respektivisht zbutjen e dënimit, për veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 428 par.2 të KPRK, për të cilën i akuzuari është shpallur fajtor dhe

dënimi i shqiptuar sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duhet të ndikojë pozitivisht tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryejë vepra penale të këtilla apo të ngjashme, preventive individuale, dhe që në të ardhmen edhe të tjerat të përmbahen nga kryerja e veprave të tilla penale, preventive e përgjithshme e që të dyja kanë për qëllim parandalimin e veprave penale dhe pritet që të arrihet edhe qëllimi i dënimit të paraparë si në nenin 41 të KPRK-së.

Me refuzimin e ankesave të PTH-DKR në Pejë dhe të mbrojtësit të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, u deshtë të vërtetohet, e në bazë të nenit 401 të KPP.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PAKR.nr.344/17, me dt.09.11.2017**

**Procesmbajtësi**  
**Eroll Gashi**

---

**Anëtarët e kolegjit**  
**Fillim Skoro**

---

**Kryetari i kolegjit,**  
**Driton Muharremi**

---

**Mejreme Memaj**

---